



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punimje/Protokoll Received/Delivery	21. 04 2021	1	viti god year
Organ /Niposa Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHEK	1926/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.231/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani- anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2293/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.307/2019 të datës 03.06.2019 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson avokati me adresë Bulevardi “Isa Boletini”, Nr.9 në Mitrovicë, kundër Vendimit KA.nr.1/2019 të datës 23.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 21.04.2021 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.307/2019 e datës 03.06.2019, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.1/2019 i datës 23.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Mitrovicës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën e punës Zyrtare Shpenzuese në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, me datë 03.06.2019 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2548/2019 të regjistruar me numër A.nr.307/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.06.2019 ankesën e ankueses, e ka proceduar të organi i punësimit për përgjigje në ankesë. Këshilli, me datë 28.06.2019 ka pranuar përgjigjen në ankese se bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të njëjtën kohë ankuesja ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 15.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2293/19 përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtojë ankesën e datës 03.06.2019 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën e ankueses të datës 03.06.2019 me numër protokolli 2548/2019 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 03.05.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë; Vendimi Ka.nr.1/2019 i datës 23.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesë për Kryetarin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë e datës 21.01.2019; Autorizimi i datës 21.01.2019 i avokatit; Akt emërimi Sa-208/2016 i datës 30.06.2019; Akt emërimi me nr.03-224 i datës 07.04.2014; Vendimi i datës 21.04.2016 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 28.06.2019 me numër protokolli 2949/2019 faqe 1/12; Aktgjykimin A.nr.2293/2019 të datës 15.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 22.08.2019 për ankuesen.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar sepse:**

Bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit me Nr.03-224 të datës 07.04.2014 ka qenë e emëruar në pozitën e punës Shefe e Njesisë për Logjistik dhe Financa, me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), mirëpo për shkak të riorganizimit të gjykatave, e njëjta me datë 03.06.2016 ka nënshkruar Akt Emërimit Nr.208/2020 të datës 30.06.2016, përmes të cilit është ri caktuar në pozitën e punës Zyrtare Shpenzuese, me koeficient të pagës shtatë (7).

Ankuesja me datën 03.05.2019 përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë lidhur me kompensimin e pagave për shkak të zvogëlimit të koeficientit nga Shefe e Njesisë për Logjistikë dhe Financa me koeficient shtatë pikë pesë (7.5), në pozitën Zyrtare e Shpenzimeve me koeficient shtatë (7).

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, përmes Vendimit KA.nr.1/2019 të datës 23.05.2019 ka hedhur poshtë si të palejuar ankesën e ankueses me arsyetimin se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

E pakënaqur me vendimin KA.nr.1/2019 të datës 23.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesja përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 03.06.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2548/2019 të regjistruar me numër A.nr.307/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së esenciale të dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike; dhe Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, përkatësisht nenin 50 ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës.* 2. *Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të një shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike, si dhe dispozitat e Rregullores 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, përkatësisht nenin 8 paragrafi 2 ku përcaktohet se: Ankesa duhet të paraqitet brenda afati prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se çdo nëpunës civil i cili pretendon që i është shkelur një e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, ka të drejtë të parashtrojë ankesë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita që i cenohen të drejtat e garantuara nga marrëdhënia e punës.*

Andaj, mbi këtë bazë ligjore, Kolegji konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, me rastin e nxjerrës së Vendimit KA.nr.1/2019 të datës 23.05.2019, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka aplikuar drejtë bazën juridike, sepse siç shihet nga shkresat e lëndës, ankuesja është caktuar Zyrtare Shpenzuese më datë 21.04.2016, ndërsa ankesë në Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka parashtruar me datë 03.05.2019, jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, si dhe nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.231/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokatit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore të Mitrovicës;
- Administratorit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.br.231/2021

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova- Veće za razmatranje i rešavanje žalbi u sastavu: Jeton Koca-predsednik, Malsore Gashi-Bajraktari i Eshref Shabani- članovi, kao i Avdyl Bekteshi- viši službenik za stručnu saradnju u svojstvu zapisničara, zasnivajući se na Presudu A.br.2293/2019 od dana 15.03.2021.godine Osnovnog suda u Prištini/Departman za Administrativna pitanja, razmotrilo je žalbu broj A.br.307/2019 od dana 03.06.2019.godine podneta od žalioca koju uz ovlašćenje zastupa advokat

na adresi Bulevar "Isa Boletini", br.9 u Mitrovici, protiv Odluke KA.br.1/2019 od dana 23.05.2019.godine doneta od Komisije za rešavanje sporova i žalbi u Osnovnom u Osnovnom sudu u Mitrovici, po pravnoj stvari "*materijalna nadoknada*", postupajući u skladu sa članom 6. stav 1 podstav 1.1, članom 18. stav 1 podstav 1.1 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova i Pravilnika br.02/2018 o Proceduri razmatranja i rešavanja žalbi u Nezavisnom nadzorom odboru civilne službe, na raspravi za savetovanje i glasanje, održane dana 21.04.2021.godine, donosi ovu:

ODLUKU

I. Odbija se kao neosnovana žalba broj A.br.307/2019 od dana 03.06.2019.godine podneta od žalioca

II. Ostaje na snazi Odluka KA.br.1/2019 od dana 23.05.2019.godine Komisije za rešavanje sporova i žalbi Osnovnog suda u Mitrovici.

O b r a z l o ž e n j e

Žalioc zaposlena na radnom mestu – službenica za troškove u Osnovnom sudu u Mitrovici, dana 03.06.2019.godine, preko ovlašćenog zastupnika, podnela je žalbu broj protokola 2548/2019 registrovana pod brojem A.br.307/2019 u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova.

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, dana 10.06.2019.godine, žalbu žalioca procesuirao je u organ poslodavca radi davanja odgovora na žalbu. Dana 28.06.2019.godine, Odbor je primio odgovor na žalbu sa priloženim dokazima u predmetu.

Zbog nedostatka kvoruma za odlučivanje u Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, žalioc je istovremeno pokrenula i upravni spor u Osnovni sud u Prištini/Departman za Administrativna pitanja. Osnovni sud u Prištini/Departman za Administrativna pitanja, dana 15.03.2021.godine doneo je Presudu

A.br.2293/19 preko koje je obavezao Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova da razmotri žalbu od dana 03.06.2019.godine podnetu od žalioca

Veće za razmatranje žalbi, za donošenje meritorne odluke utvrdilo je sledeće dokaze: Žalbu žalioca od dana 03.06.2019.godine broj protokola 2548/2019 podneta u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova; Žalbu od dana 03.05.2019.godine podnetu Komisiji za rešavanje sporova i žalbi u Osnovnom sudu u Mitrovici; Odluku Ka.br.1/2019 od dana 23.05.2019.godine Komisije za rešavanje sporova i žalbi; Zahtev za predsednika Osnovnog suda u Mitrovici od dana 21.01.2019.godine; Ovlašćenje advokata od dana 21.01.2019.godine; Akt o imenovanju Sa-208/2016 od dana 30.06.2019.godine; Akt o imenovanju br.03-224 od dana 07.04.2014.godine; Odluku od dana 21.04.2016.godine i Odgovor na žalbu od organa poslodavca od dana 28.06.2019.godine broj protokola 2949/2019 stranica 1/12; Presudu A.br.2293/2019 od dana 15.03.2021.godine Osnovnog suda u Prištini-Departman za Administrativna pitanja; Obaveštenje od dana 22.08.2019.godine za žalioca.

Veće za razmatranje žalbi, nakon razmatranja svih predmetnih spisa podnetih od stranaka, utvrdilo je da je žalba žalioca **neosnovana, jer:**

Na osnovu dokaza u predmetu, utvrđeno je da je žalioac shodno Akt o imenovanju br.03-224 od dana 07.04.2014.godine bila imenovana na radnom mestu – šefica Jedinice za logistiku i finansije, sa koeficijentom plate sedam tačka pet (7.5), međutim zbog reorganizacije sudova, ista je dana 03.06.2016.godine potpisala Akt o imenovanju br.208/2020 od dana 30.06.2016.godine, preko kojeg je ponovo imenovana na radno mesto- službenica za troškove, sa koeficijentom plate sedam (7).

Dana 03.05.2019.godine, žalioac je preko ovlašćenog zastupnika, podnela žalbu Komisiji za žalbe u Osnovni sud u Mitrovici, u vezi nadoknade plata zbog smanjenja koeficijenta sa radnog mesta- šefica Jedinice za logistiku i finansije sa koeficijentom sedam tačka pet (7.5), na radno mesto – službenica za troškove sa koeficijentom sedam (7).

Komisija za rešavanje sporova i žalbi, na osnovu Odluke KA.br.1/2019 od dana 23.05.2019.godine, odbacila je kao nedozvoljenu žalbu žalioca, uz obrazloženje da je žalba podneta izvan zakonskog roka utvrđenog odredbama člana 127. stav 1 Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, i člana 8. stav 2 Pravilnika br.05/2011 o Procedurama rešavanja sporova i žalbi.

Nezadovoljna odlukom KA.br.1/2019 od dana 23.05.2019.godine, doneta od Komisije za rešavanje sporova i žalbi, preko ovlašćenog zastupnika, dana 03.06.2019.godine, žalioac je podnela žalbu broj protokola 2548/2019 upisana pod brojem A.br.307/2019 u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, zbog bitnog kršenja odredaba Zakona o Civilnoj službi Republike Kosova, pogrešno i nepotpuno utvrđenog činjeničnog stanja i pogrešne primene materijalnog prava.

Veće za razmatranje žabi, u vezi razmatranja žalbenih tvrdnji žalioca, analiziralo je odredbe Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi, odnosno član 50. gde je utvrđeno da: *1. Civilni službenici imaju pravo žalbe protiv administrativne odluke ili bilo koje povrede i propusta u pravilima ili u opštim upravnim postupcima, koji utiču i koji se odnose na njihov radni odnos. 2. Civilni službenici imaju pravo na zaštitu preko internih upravnih ili sudskih postupaka u slučaju povrede njihovih prava koje rezultira nekim aktom javne uprave,* kao i odredbe Pravilnika 05/2011 o Procedurama rešavanja sporova i žalbi, odnosno član 8. stav 2 gde je utvrđeno da: *“Žalba se treba podneti u roku od trideset (30) dana od momenta kada civilni službenik smatra da su mu prekršena njegova prava iz radnog odnosa,* i kao rezultat toga, utvrdilo je da svaki civilni službenik koji tvrdi

da mu je prekršeno jedno pravo iz radnog odnosa, ima pravo podnošenja žalbe u roku od 30. dana od dana kada su mu prekršena prava zagarantovana radnim odnosom.

Dakle, po ovom pravnom osnovu, Veće konstatuje da je Komisija za rešavanje sporova i žalbi u Osnovnom sudu u Mitrovici, prilikom donošenja Odluke KA.br.1/2019 od dana 23.05.2019.godine, utvrdila pravedno činjenično stanje i primenilo je pravilno pravnu osnovu, jer kao što se vidi iz predmetnih spisa, žalioc je sistematizovana kao Službenica za troškove dana 21.04.2016.godine, dok je žalbu u Komisiji za rešavanje sporova i žalbi podnela dana 03.05.2019.godine, što je izvan zakonskog roka utvrđenog u članu 8. stav 2 Pravilnika 05/2011 o Procedurama rešavanja sporova i žalbi, kao i člana 127. stav 1 Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, tako da Veće konstatuje da su žalbene tvrdnje žalioca neosnovane.

Dakle, nakon analiziranja o ocene svih predmetnih spisa, kao i na osnovu člana 18. stav 1 podstav 1.1 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, Veće je odlučilo kao u dispozitivu ove odluke.

Odluka stupa na snagu na dan potpisivanja od strane predsednika Veća.

Pravna pouka: Protiv odluke Odbora, nezadovoljna stranka koja tvrdi da je odluka Odbora nezakonita, može pokrenuti upravni spor u Osnovni sud u Prištini-Departman za Administrativna pitanja, u roku od trideset (30) dana od dana kada joj je predata odluka. Pokretanje upravnog spora ne zadržava izvršenje ove odluke

NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
Predmet broj A.br.231/2021

Avdyl BEKTESHI

Viši službenik za stručnu saradnju

Jeton KOCA

Predsednik Veća

Odluku dostaviti:

- Zastupniku žalioca advokatu
- Generalnom direktoru Sekretarijata Sudskog saveta Kosova;
- Predsedniku Osnovnog suda u Mitrovici;
- Administratoru Osnovnog suda u Mitrovici; i
- Arhivi NNOCSSK-a.

Preveo:
Sh. Mujko

Dana, 21.04.2021.god.

